

[Printo]

[Google Translate]

**VENDIM****Nr.333, datë 26.1.2011****PËR ADMINISTRIMIN E VENDDEPOZITIMEVE RAJONALE TË MBETJEVE URBANE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 12, pika 4, 13, pika 1 e 54 shkronja "h" të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", të ndryshuar, dhe të neneve 5, pika 2 e 21 të ligjit nr.9010, datë 13.2.2003 "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Administrimi i vend depozitimeve të mbetjeve urbane të bëhet në nivel rajonal nëpërmjet këshillave të qarqeve përkatëse.
  2. Njësitë e qeverisjes vendore në nivel qarku bashkëpunojnë ndërmjet tyre me qëllim harmonizimin e politikave rajonale për ushtrimin e funksioneve të përbashkëta.
  3. Këshillat e qarqeve të bashkëpunojnë me njësitë e qeverisjes vendore, Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe, brenda vitit 2011, të përcaktojnë e të miratojnë sipërfaqet ku mund të ndërtohen venddepozitimet rajonale të mbetjeve urbane.
  4. Përzgjedhja dhe përcaktimi i venddepozitimeve rajonale të mbetjeve urbane të bëhen në përputhje me strategjinë dhe planin kombëtar të menaxhimit të mbetjeve.
  5. Këshillat e qarqeve, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, duhet të planifikojnë sipërfaqe të caktuara për t'u përdorur për administrimin e automjeteve të dala jashtë përdorimit, si dhe të përcaktojnë venddepozitimet për mbetjet e ndërtimit.
  6. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, brenda vitit 2011, të përcaktojë nevojën për financime për hartimin e studimeve të fisibilitetit, projektimin dhe zbatimin e projekteve të venddepozitimeve të përcaktuara sipas pikës 3 të këtij vendimi.
  7. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, prefektët, njësitë e qeverisjes vendore dhe këshillat e qarqeve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI****Sali Berisha**Copyright 2012 - [www.ligjet.org](http://www.ligjet.org)